

-Termt e Referencave-

Grupi punues vetë-qeverisë për pjesëmarrjen e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve të projektit "Praktikat më të mira për integrimin e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve"

Sfondi

Mandatar nga Planini I Veprimit për romët dhe sinti të OSBE-së I vitit 2003, (Kapitulli VII), Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) e ka adresuar situatën e romëve dhe grupeve gjegjëse, në situata të krizave dhe post-krizave në Rajonin Ballkanin Perëndimor, në veçanti, i cili ka qenë i prekur nga tensionet etnike dhe konfliktet në 1990-tat. ODIHR-i kushton vëmendje të veçantë situatës së romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve, përfshirë situatën dhe riintegrimin e personave të zhvendosur të këtyre komuniteteve.

Shumë vende në rajon kanë zhvilluar strategjitë dhe planet e veprimit të integritit të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve, megjithatë, zbatimi i tyre në nivel lokal dhe ndikimi i parashikuar mbi situatën e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve në fushat e arsimit, punësimit, strehimit dhe qasjes në shërbime publike është një proces afat-gjatë. Qeveritë e Ballkanit Perëndimor shpesh kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të rritur përpjekjet në zbatimin e planeve të veprimit për të siguruar që romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët të përfitojnë prej tyre, me të vërtetë. Në këtë përpjekje komuniteti ndërkombëtar mund të luajë një rol kyç në mbështetjen e qeverive, në nivel kombëtar dhe lokal.

Në vitin 2011, ODIHR-it iu dhan fonde të BE për një projekt rajonal në Ballkanin Perëndimor për forcimin e kapaciteteve të qeverive lokale dhe kombëtare dhe mekanizmave që kanë të bëjnë me romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët dhe për rritjen e integritit të këtyre komuniteteve në shoqëri. Projekti rajonal "Praktikat më të mira për integrimin e romëve" (BPRI) filloi më 1 janar 2012 dhe do të zgjasë 23 muaj. Objektivat specifike të projektit janë:

- të rrisë pjesëmarrjen romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve në vendim-marrje dhe politikat me interes të tyre,
- të rrisë qasjen në regjistrimin civil dhe shërbimet të ndihmës ligjore për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët,
- fuqizimin e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve për të përfituar nga nismat që synojnë të legalizojnë apo përmirësojnë situatën e tyre të banimit,
- të rrisë pjesëmarrjen e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve në jetën publike, dhe

* Ky cilësim bëhet pa paragjykim mbi pozicionin dhe statusin dhe në përputhje me RKSKB 1244/99 si dhe mbi opinionin e GJND mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës

- të nxitë iniciativa dhe koordinime ndërkuftare për përmirësimin e pjesëmarrjes së romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve.

Projekti do të zbatohet në juridiksionet e mëposhtme: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kosovë *, Mali të Zi dhe Serbi.

Roli dhe Përgjegjësitë e Grupit Punues Vetë-Qeverisës (SGWG)

Qëllimi i SGWG është të promovojë shkëmbimin e iniciativave/praktikave të përfshirjes së romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve në struktura dhe aktivitete të vetë-qeverisjes, si dhe për të ofruar mundësi për mësim të ndërsjellë dhe ndërtimin e kapaciteteve. Përfaqësuesit e komunave të interesuara në adresimin e çështjeve romë, ashkalinje dhe egjiptiane në secilin juridiksion do të marrin pjesë në të, pas miratimit nga ana e Komitetit Rajonal të Koordinimit të Projektit(RPCC). Përveç kësaj, edhe asociacionet e njëjësive të vetqeverisjes lokale (aty ku vepron) dhe OJQ-të romë, ashkalinje dhe egjiptiane do të përfaqësohet në SGWG. Atëherë kur është e mundur, takimi rajonal do të paraprihet nga takimet përgatitore të nivelit kombëtar.

Pjesëmarrësit e GPVQ ndërmarrin përgjegjësitë e mëposhtme:

- Paraqitja e përvojës së organizatës/institucionit të tyre në temën e dhënë;
- Shkëmbim kontaktesh me pjesëmarrësit e tjerë, duke iu përgjigjur pyetjeve të tyre pas takimit, nëse ndojkush interesohet;
- Nëse paraqitet një nevojë për bashkëpunim me të thelluar, secili delegacion organizon këso takime, pret delegacione nga vende të tjera dhe organizon takime me aktorët të tjerë lokalë (këto vizita mund të organizohet nga BPRI);
- Këmbimi i çdo materiali të dobishëm që mund të përkthehet dhe shpërndahet në të gjithë rajonin (raportet, planet e veprimit, kurrikula të trajnimit, termat e referencës, etj);
- Krijimi i sinergjive duke kërkuar marrëveshje për programe dhe projekte të ngjashme;
- Identifikimi i praktikave të reja të mira dhe mësimet e nxjerra të cilat mund të theksohen nga projekti BPRI.

BPRI do të përgatisë një raport përmbledhës pas çdo takimi të SGWG dhe do të shpërndajë atë për pjesëmarrësit. Kur është e mundur, takimi SGWG do të mbahet së bashku me ngjarjet e tjera tematike.

Tema e takimit të parë, që do të mbahet në shtator 2012, do të jetë banimi, pasi BPRI po e mban takim së bashku me Tryezën parë të rrumbullakët mbi banimin. Në çdo takimi, anëtarët do të kenë një mundësi për të propozuar temën e takimit ardhshëm, i cili do të mbahet në fillim të 2013.

Prakticitete: SGWG i propozuar do të presë max 30 pjesëmarrës për çdo takim. SGWG do të takohet çdo gjashtë muaj, dy takime të tjera janë planifikuar deri në fund të projektit. Nuk do të ketë anëtarësime fikse individuale në këtë SGWG, por anëtarësimi mbetet me komunën zgjedhur nga RPCC, kështu që komuna mund të identifikojë kandidatin më të mirë të mundshëm për këtë grup punues. BPRI projekti do të mbulojë shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit dhe të bëjë të gjitha aranzhmanet. Përkthimi do të ofrohet në gjuhën shqipe, boshnjake / kroate / malazeze / serbe, angleze dhe gjuhën maqedonase.

Kontakt informatat: Sekretariati për GPVQ gjendet në zyrën e OSBE/ODIHR në Varshavë – Ju lutemi që të kontaktoni Z.Vladimir Rusiq, Vladimir.rusic@odhr.pl.